

SHPËRBLIMI MBËSHTETËS

Të nderuar miq, akademikë, botues të librit shkencor dhe të tjerë të pranishëm,

Kemi zgjedhur pikërisht këtë edicion të Panairin e Librit Shkencor, që këtë ngjarje për ne me rëndësi në fushën e shkencës, ta pasurojmë me një eveniment të veçantë, që është Shpërblimi mbështetës për punën kërkimore-shkencore të të rinjve.

Akademia jonë e konsideron obligim përkujdesjen ndaj shkenctarëve të rinj dhe ky çmim, bashkë me Akademinë e të rinjve, të cilën mendojmë ta themelojmë së shpejti, besojmë se është një hap i vogël në drejtimin e duhur.

Ashtu sikundër është thënë edhe në konkursin e shpallur për këtë rast, çmimi jepet me qëllim vlerësimit dhe promovimit të arritjeve shkencore të brezit të ri, që është një ndër objektivat kryesore të planit strategjik të Akademisë sonë. Të drejtë aplikimi kanë pasur shkencëtarët kosovarë të disiplinave shkencore nga shkencat shoqërore, albanologjia, shkencat e natyrës dhe shkencat teknike, si dhe të studimeve në fushën e arteve.

Fakti që në këtë konkurs ka marrë pjesë një numër i konsideruar shkencëtarëve të rinj, lë të kuptohet se puna shkencore-kërkimore nuk është një “tokë djerrë” ose “tokë e panjohur” (terra inkognita, siç do të thoshin latinët), përkundrazi, është një tokë që lëvrohet me shumë përkujdesje dhe pasion.

Fjalën e ka Fetah Podvorica, sekretari i Seksionit të shkencave të natyrës që ta shpallë fituesin e shpërblimit mbështetës.